


RELACION

TEKNIK

PER PROJEKTIN E ZBATIMIT TE OBJEKTIT:

SISTEMIM-ASFALTIM I RRUGES “RAMIZE GJEBREA LOTI 2 ” VLORE



RELACION TEKNIK

Rikonstruksioni i rruges Ramize Gjebrea LOTI 2

RELACION TEKNIK

I PROJEKTIT TEKNIK TE OBJEKTIT

“SISTEMIM-ASFALTIM I RRUGES “RAMIZE GJEBREA LOTI 2 ” VLORE”

Projekt - zbatimit, konsiston ne zgjidhjen optimale per vazhdimin e projektit ne fazen e dyte te rikonstrukcionin dhe asfaltimin e rruges Ramize Gjebrea

- nga kryqëzimi i trgut te perimeve e bonifikimit deri tek ura e sodes me gjatesi rreth 1712 m; m 880,48, piketa 26 – piketa 71 m 2.580,06
- lidhja me rrethrotullimin e fillimit te autostrades Vlore Levan, piketa A1 - deri tek ura e “Nartes – m 0.000 piketa 1, gjatesi 99.25 m
- lidhjet me rruget anesore qe kryqezohen me kete aks
- lidhja me rrugen Sazani – fundi i projektit “ Rikonstrukcioni i rruges Sazani dhe vazhdimi i rruges se Nartes gjatesi 600 m
- nje ure pedonale me gjeresi 2.0 m perkrah ures se Nartes, per kalimin e kembesoreve

Planimetria e rrugeve qe ne paraqesim, pjesa me e madhe ndodhet ne gjendje shume te keqe per shkaqet e meposhtme:

- Amortizimi i trupit te rruges dhe shtresave, per shkak te mungeses se mirembajtjes dhe kanalizimeve te ujrave te bardha (shiut)
- Konsumimi i shtresave te ndertuara nga kalimi i mjeteve te ndryshme.

Grupi i projektimit gjate hartimit te kesaj projekt-zbatimi ka kryer rikonicionin ne vend te gjendjes si dhe matjet e plota topografike.

Gjate studimit u moren parasysh kushtet e terrenit ku kalon rruga, si dhe kerkesat e detyres se projektimit.

Rruga do te kete nje gjeresi mesatare rreth 7 m ,prej te cilave 6m asfaltim dhe 2x50cm kunete betoni.

Ne gjatesine e rruges se demtuar do te zbatohen te gjitha shtresat e rrugeve si

- Shtrese cakelli me mbeturina kave 50 cm
- Shtrese cakelli makinerie 20 cm
- Shtrese stabilizanti 15 cm
- Shtrese binderi 6 cm
- Shtrese asfalto betoni 4 cm

Nga ana gjeometrike jane bere permiresimet e nevojshme, duke i dhene rruges konfigurimin e duhur

PROJEKTI

Projekti parashikon asfaltimin komplet te rruges prej 1712 m + 99.25 m .

Gjate hartimit te ketij projekti jane realizuar keto objektiva kryesore:

-Rikonstruksioni i rruges eshte projektuar me gjeresi te vijes se kalimit te asfaltuar 6 m, pa trotuare ,me kasoneta 2x0,5mdhe 2x0.5m bankina .

Nje trotuar me gjeresi prej 2 m si dhe kanal anesor kullimi.

Jane mare masa per largimin e plote te ujrave duke vendosur pusetat e grumbullimit te ujrave siperfaqesore e si: kunetat e betonit 40 x 60 x

1.0 m dhe tubat e shkarkimit me kanalet anash, Ø315 mm plastik te korrugat .

Kanalet e kullimit do te vazhdohen përgjatë gjithë gjatësisë dhe do te lidhet nen rrugët anesore me tubacione ø600 mm . Kanalet do te vishen ne pllaka betoni ose beton te derdhur me sp. 10 cm.

Eshte parashikuar edhe ndertimi i nje ure te vogel pedonale anash ures se nartes me gjeresi 2.0 m e ecila do te lidhe dy trotuaret pedonal.

SHTRESAT RRUGORE

Ne funksion te trafikut, bazamentet ku kalojn rruga dhe matrialeve te ndertimit qe do te perdoren, jane percaktuar shtresat e rruges per secilin segment rrugor, te cilat jepen ne profilat terthore tip, te materialit grafik.

Per kategorine e projektimit qe ka rruga (sipas detyres se projektimit), numri maksimal i mjeteve qe parashikohet te kalojne ne to eshte rreth 1000 mjete njesi ne dite, me perspektive per 20 vjet, me ritje mesatare vjetore prej rreth 4 %. Per kete numur mjeteshtresat rrugore. Gjithashtu ne rruget ekzistuese do te behet plotesimi i shtresave ekzistuese me shtresat e tjera te nevojeshme.

Shtresat e parashikuara ne projekt jane:

Km 0-1712 m

4cm shtrese asfaltobeton

6 cm shtrese binderi

TROTUARET

Trotuaret do te kufizohen nga dy bordura 15x25 cm dhe 20x30 cm. Do te formohen nga pllaka granili me ngjyre sp. 4 cm te shtrira mbi nje shtrese betoni 6 cm dhe shtrese cakell i ngjeshur me makineri 15 cm. Perpara shtrimit me shtresa terreni natyral do te ngjeshet me makineri per te evituar ulje te mëtejshme pas aplikimit te shtresave.

SHPRONESIMET

Nuk ka nevojë për shpronesime pasi toka ku kalon rruga është prone e shteterore.

ORGANIZIMI I PUNIMEVE

Për rikonstrukcionin e rruges është parashikuar që materialet e ndertimit do të prodhohen me guri kave që gjendet në guroret e rrethit . Materiali i asfalto betonit do të vijë i gatshëm nga nyjet me të afërta në përputhje me kërkesat e projektit

Te gjitha punimet janë parashikuar të kryhen në përputhje me specifikimet teknike që i bashkëngjiten këtij projekti.

Preventivi i punimeve është dhënë për të gjithë rrugën .

Në preventiv janë parashikuar të gjithë zerat e punimeve sipas specifikimeve teknike të këtij projekti, çmimet janë marrë nga Manuali i teknike të ndertimit, VKM NR. 629 dt. 15.07.2015.

Për të gjitha zerat e punimeve janë bërë analizat e prodhimit dhe vendosjes në veprë në përputhje me organizimin e punimeve, standartet dhe kushtet teknike në fuqi.

Bashkengjitur ketij raporti jane dhene; specifikimet teknike te punimeve, volumet e punimeve me vleresimet e kostos, dhe preventivi perkates

Ne preventivin e punimeve parashikohet punime te domosdoshme per riaktivizimin dhe rikonstruksionin te ndonje segmenti te mundshem qe do te rezultojte i demtuar dhe jashte funksionimit . punime keto qe duhet te konfirmohen mbas verifikimit nga ekipi i specializuar i Ndermarrjes se Sherbimeve Publike .

Situacionimi i ketyre punimeve do te behen mbas verifikimit dhe matjes se punimit ne proces verbalin e vecante qe do te hartohet nga drejtuesi i punimeve , kontraktori dhe drejtuesi teknik i punimeve.

Grupi i Projektimit

